



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DELVINË  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Delvinë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje materiali asfalt”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Asfalt 44113620-7

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4,123,110** (katërmilionë e njëqindë e njëzetë e tre mijë e njëqindë e dhjetë) Lekë, pa TVSH.

**Argumentimi:** Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhërin Nr. 2265 Prot, datë 10.10.2024, e ngarkuar për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës dhe ndjekjen e hapave të metejshëm të kësaj procedure prokurimi, për çdo mall objekt prokurimi, në zbatim të Nenit 76, pika “1”, gërma “b” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, ju drejtua 3(tre) operatorëve ekonomik, nga të cilët morëm treguesit e çmimeve për çdo njësi/testim tregu.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Delvinë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

➤ Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 1 e Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar e kontratës dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e limit të kësaj kontrate, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit Nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiarë (2021, 2022, 2023) të

paraqitur në Autoritetet përkatëse Tatimore, të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar)

*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit Nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 dhe këstin përkatës të maturuar për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d)

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

**Përsa i përket aftësisë teknike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:**

**2.3.1 Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme** në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, për të cilën konkuron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë:

a. Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një Ent publik, kontrata furnizimi dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

**(ose)**

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20% të vlerës limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik për mallrat objekt prokurimi duhet të disponoj në një nga format: Pronësi/Qera **ose** Kontratë Furnizimi të lidhur para noterit me afat vlefshmërie (minimuni deri në përfundim të kontratës) fabrikën/impiantin si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Statusi
1.	Fabrikë asfalti	1 copë	Në pronësi ose me Qera ose Kontratë furnizimi
2.	Impiant për prodhimin e Bitumit (Prajmerit)	1 copë	Në pronësi ose me Qera ose Kontratë furnizimi

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin për impiantin e asfaltit në pronësi kontratën e blerjes apo zhdoganimit ose fatura tatimore përkatesë, leje mjedisore lëshuar nga QKL, fotot, vendodhjen e impjantit, kartë teknologjike për prodhim e asfaltobetonit, së bashku me raportin përkatës. Kjo sipas nenit 43, pika 2, e VKM-së Nr. 612 datë 05.09.2012, për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, i ndryshuar.
- Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qeraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit, (kjo kontratë duhet të jetë e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës së furnizimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë të përfshirë në aktivitetin e tyre objektin për të cilën prokurohet, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.3.3** Operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë.

Për këtë subjekti ofertues duhet të paraqesi certifikatën e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose Ekuivalenten e saj (të vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë” të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vetë natyrën e objekt kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si furnizues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar

në nenin 79 të ligjit Nr. 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **(Deklaratë)** nga Administratori, me anë të së cilës deklaron se merr përsipër në çdo kohë transportin dhe furnizimin e Autoritetit Kontraktor në çdo ditë të javës, në vendin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, me mallrat objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Autoriteti Kontraktor në formulimin e këtij kriteri kërkon prej Operatorit Ekonomik (Përfaqësuesit të subjektit) një deklaratë me anë të së cilës deklaron se merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi deri në vendin e ekzekutimit të kontratës (Siç përcaktohet në Dokumentat Standarte të Tenderit), pa përfshirë kosto shtesë për këtë shërbim.

**2.3.5** Për të provuar kapacitetet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë:

Nr.	Emërtimi i mjetit	Sasia	Statusi
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton.	3 copë	Në pronësi ose me qera
2.	Autobitumatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qera

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- g) leje transporti e lëshuar nga njësia vendore.

Kur janë me qira, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- g) leje transporti e lëshuar nga njësia vendore.

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera, si dhe të deklarojë se pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës dëshmon se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

### **2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht:**

- 3 (tre) Drejtues mjete për kamion (Kategoria C minimale), për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet kompetente.

**Shënim:** *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësisimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet e kërkuara janë vendosur në proporcion me afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Numri dhe lloji i makinerive në pronesi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

## **II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike**

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Formulari i Specifikimeve Teknike përshkruhet në Shtojcën 6 të DST.

**Shënim:** Në zbatim të nenit 36 të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në Dokumentat e Tenderit, Specifikime Teknike apo çdo dokument tjetër shoqërues është cituar ndonjë markë, patentë, origjine etj..., përfshihet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”, pasi në cdo rast emërtimi mund të jetë bërë për arsye orientimi dhe nuk ka efekt kufizues apo përjashtues.

Komisioni unanimitisht bëri miratimin e këtyre kritereve për kualifikim dhe vendosi vazhdimin e mëtejshëm i procedurave në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

1. \_\_\_\_\_  
(Emri, Mbiemri, Firma)

2. \_\_\_\_\_  
(Emri, Mbiemri, Firma)

3. \_\_\_\_\_  
(Emri, Mbiemri, Firma)